

PROGRAMI

Diskutim në panel: Under Construction

Vendi: Mitrovicë e Veriut, Qendra për Energji Qytetare

Data: 28 shkurt 2018

- 09:30 – 10:00** Ardhja e pjesëmarrësve dhe regjistrimi
- 10:00 – 10:30** Fjalë mirëseardhjeje dhe përshëndetje – Tijana Obradović, Qendra për Energji Qytetare (2 min)
Fjalë hyrëse - përfaqësuesi nga KFOS-i (5 min)
Shfaqja e filmit dokumentar Pokreni se i poguraj (Shkundu dhe shtyje), produksioni Omonia (18 min)

10:30 – 11:30 Paneli I: Rreth Marrëveshjes së Brukselit dhe zbatimit të tij

Dialogu ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit dhe zbatimi i disa marrëveshjeve të dala nga ky dialog vlerësohen si procese më të rëndësishme që drejtpërdrejt ndikojnë në cilësinë e jetës së qytetarëve, në veçanti të qytetarëve të Mitrovicës së Veriut dhe tri komunave të tjera në veri të lumit Ibër, por edhe në marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Derisa disa marrëveshje janë ende vetëm në letër dhe nuk dihet se kur dhe si do të filloj zbatimi i tyre, disa marrëveshje po zbatohen, siç është marrëveshja për integrimin e gjyqësorit, telekomunikimet, për lirinë e lëvizjes, për hapjen e urës kryesore mbi Ibër etj. Procesin e dialogut e ndjek opinioni tashmë i krijuar për jotransparencën e tij. Nëse në të vërtetë është jotransparent, sa ndikon zbatimi i disa marrëveshjeve në jetën më të mirë të qytetarëve, të marrin shërbime më të mira, a janë marrëdhëniet e ndërsjella ekonomike më të mira se ato politike, a janë harruar disa tema të rëndësishme dhe a ndikon dialogu në normalizimin e marrëdhënieve jo vetëm ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, por edhe në marrëdhëniet e serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë apo sillemi në rreth, janë vetëm disa pyetje me të cilat do të merremi në panelin e parë.

Moderator: Željko Tvrdišić

Panelistët:

Dušan Radaković – Qendra për avokimin e kulturës demokratike, (10 min)

Sanja Sovrlić ose Snežana Đapić– OJQ Radio Mir, (10 min)

Dragiša Mijačić ose Jovana Jakovljević – Instituti për zhvillim ekonomik territorial, (10 min)

Bojan Teofilović – Qendra për paqe dhe tolerancë. (10 min)

Diskutim (15 min)

- 11:30 – 11:45** Pauzë për kafe

11:45 – 13:00 Paneli II: Rreth aktivizmit, përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve

Qytetari i vetëdijshëm, aktiv dhe i përgjegjshëm është themel për shoqëri demokratike të shëndoshë dhe të begatshme. Jemi dëshmitar të bashkimit të qytetarëve rreth problemeve globale, lëvizjeve qytetare që avokojnë për mbrojtjen e drejtave të tyre dhe të tjerëve duke përdorur për këtë të gjitha mjetet e lejuara me ligj, ndërsa shpesh përdorin edhe artin dhe mjetet tjera inovative për të tërhequr vëmendjen e institucioneve përgjegjëse dhe me këtë të ndikojnë në zgjidhjen e problemit. Pa qytetarë, si “tregues” të problemeve, nga njëra anë, dhe

kënaqshmërisë së tyre si shfrytëzues përfundimtar të shërbimeve, nga ana tjetër, vijmë në situatë të konstatojnë shpesh se ligjet janë të mira, porse zbatimi është i keq. Sa jemi të gatshëm për bashkim, bashkëpunim për një jetë në mjedis më të pastër dhe më të shëndetshëm, në çfarë mënyre mund të përshejtojmë pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes, si i shohin të rinjtë të gjitha këto dhe a janë të gatshëm për përfshirje më aktive në rrjedhat e shoqërisë, si mund të ndihmojmë të bashkuar në zhvillimin e ambientit dhe të gjithë shoqërisë, është tema e panelit të dytë.

Moderator: Anđelka Čup

Panelistët:

Aca Mitić ose Jovana Radosavljević – Nisma e Re Sociale, (10 min)

Milan Barać – Ekipi Ekspertëve Ekologjik-Mjekësor (10 min)

Nexhmedin Spahiu – RTV Mitrovica (10 min)

Jovana Stojanović – Qendra Edukative Rinore Sinergija, (10 min)

Miodrag Milićević – OJQ Aktiv (10 min)

Diskutim (15 min)

13:00 – 14:15 Drekë për pjesëmarrësit, restorant:

14:15 – 15:15 **Paneli II: Rreth ngjashmërive dhe dallimeve**

Ura është konstruksion i ndërtuar për tejkalimin e pengesave natyrore ose artificiale. Kështu thotë përkufizimi. Ura mbi Ibër është e vetmja urë e cila nuk shihet si konstruksion i thjeshtë por është simbol i ndarjes jo vetëm në Mitrovicë Veriore dhe Jugore, por shumë thellë, në kuptimin e realitetit në të cilin jetojnë fqinjët tanë në anën tjetër të urës. Mosnjohja dhe mosdija rreth fakteve se si të tjerët, nga ana tjetër, jetojnë, me çka ballafaqohen, çka i mundon ose i bën të lumtur, nxit paragjykime dhe sjell ndarje. Këto ndarje, jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë në regjion, janë zakonisht të natyrës ndëretnike, por asgjë më pak nuk janë të rrezikshme as ato brenda një komuniteti. Sa njihemi, çka mendojmë kur themi “veri” ose “jug”, nëse dhe si kuptohemi ndërmjet vete dhe a janë gjuha dhe komunikimi ato që mund të kontribuojnë në kuptimin më të mirë të ndërsjellë është temë diskutimin në panelin e tretë.

Moderator: Sanja Sovrlić

Panelistët:

Zana Sylja – Qendra për Zgjidhje Alternative të Kontesteve, (10 min)

Maja Mladenović – RTV Herc, (10 min)

Isak Vorgučić – RTV Kim, (10 min)

Ivan Nikolić – Komunikimi për Zhvillim të Shoqërisë, (10 min)

Diskutim (15 min)

15:15 – 15:30 Pauzë për kafe

15:30 – 15:45 Konkluzione - Moderatorët bëjnë përmbledhje të paneleve